



VIKTIMA E TRAFIKIMIT NJERËZORË KA TË DREJTË QË TË NDIHMOHET

Në këtë broshurë ka informacione për ndihmë viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

Sistemi për të ndihmuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (sistemi i ndihmës) është një palë zyrtare që ndihmon viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Finlandë.

KUJT i dedikohet ndihma?

Ti mund të bëhesh klient i sistemit për të ndihmuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nëse je

- viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për këtë arsye keni nevojë për ndihmë.
- një fëmijë i rënë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore në Finlandë, që ka nevojë për ndihmë.
- një person që ndihmon në hetimin e një krimi të trafikimit të qenieve njerëzore, nëse keni nevojë për ndihmë të veçantë

Sistemi i ndihmës ndihmon njerëzit e të gjitha moshave dhe të të gjitha kombësive, gjinive dhe feve. Gjithashtu shtetas finlandezë.

Mund të merrni ndihmë edhe nëse jeni në Finlandë pa të drejtë të ligjshme qëndrimi. Ju mund të merrni ndihmë edhe nëse jeni vetë i akuzuar për krime.

Mund të merrni ndihmë edhe nëse nuk e raportoni krimin

Mund të merrni ndihmë nga sistemi i ndihmës, edhe nëse nuk dëshironi të raportoni në polici krimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Sistemi i ndihmës nuk do t'ju raportojë në polici. Ju mund të ndihmoheni për të paraqitur një krim, nëse dëshironi të bëni paraqitjen e një krimi.

ÇFARË NDIHME mund të merrni nga sistemi i ndihmës?

Mund të merrni ndihmë nga sistemi i ndihmës kur jeni klient i sistemit të ndihmës.

Ndihma mund të jetë, për shembull, si kjo:

- Këshillim dhe udhëzim
- Ndihmoheni në paraqitjen e një krimi, nëse dëshironi të bëni kallëzim penal
- Për tu mbështetur dhe mbrojtur gjatë një procesi të mundshëm penal
- Ndihmoheni për të marrë sistent ligjor dhe person mbështetës, nëse ju nevojiten
- Shërbimet shëndetësore
- Shërbimet sociale
- Akomodimi i sigurt
- Mbështetje financiare, nëse nuk keni para
- Shërbime përkëthimi gojor dhe tekstual, nëse keni nevojë për to

Përveç këtyre, për shtetas të huaj jepen edhe këto ndihma:

- Nëse jeni duke qëndruar në Finlandë pa të drejtë ligjore qëndrimi, sistemi i ndihmës mund të ju japë një *periudhën e shqyrtimit*. Periudha e shqyrtimit do të thotë që ju jeni legalisht në Finlandë për 1 – 6 muaj dhe nuk mund të largoheni nga vendi gjatë kësaj kohe.
- Mbështetjen e kthimit të mbrojtur, nëse dëshironi të ktheheni në vendin tuaj
- Këshilla dhe udhëzime në lidhje me aplikimin për leje qëndrimi

Së bashku me ju, ne mendojmë se çfarë ndihme ju nevojitet.
Ju nuk duhet të pranoni ndihmën që nuk e dëshironi.



Kështu organizohen shërbimet

Sistemi i ndihmës ju ndihmon të gjeni shërbimet që ju nevojiten

- Nëse keni vendbanim në Finlandë

Në Finlandë, ju i merrni shërbimet tuaja nga zona e mirëqenies. Sistemi i ndihmës bashkëpunon me zonën e mirëqenies. Ju merrni udhëzime dhe këshilla nga sistemi i ndihmës.

- Nëse jeni azilkërkues

Shërbimet tuaja bazë mund t'i merrni në qendrën e pritjes. Sistemi i ndihmës ju ndihmon në bashkëpunim të ngushtë me qendrën e pritjes. Ju gjithashtu mund të merrni udhëzime dhe këshilla nga sistemi i ndihmës.

- Nëse nuk keni vendbanim në Finlandë

Sistemi për të ndihmuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore organizon shërbimet për ju

Kështu bëheni klient në sistemin e ndihmës

Punonjësi social, organizata, policia apo edhe një punonjës i kishës mund t'ju udhëzojë te sistemi i ndihmës në mënyrë që të merrni ndihmë. Ata mund të ju referojnë te sistemi i ndihmës vetëm nëse jepni leje. Dhënia e lejes do të thotë që ata mund t'i japin të dhënat tuaja personale sistemit të ndihmës.

Sistemi i ndihmës ka nevojë për informacione rreth asaj që ju ka ndodhur dhe për çfarë lloj ndihme keni nevojë.

Nëse sistemi i ndihmës ka nevojë për më shumë informacione për situatën tuaj, ai mund të ju pyet ju ose autoritetet tjera për këtë.

Bazuar në informacionin, punonjësi i sistemit të ndihmës vlerëson nëse mund të jeni bërë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për këtë arsye keni nevojë për ndihmë nga sistemi i ndihmës.

Gjithashtu mund të aplikoni vetë për t'u bërë klient

Gjithashtu mund të aplikoni vetë për t'u bërë klient i sistemit të ndihmës për viktimat e trafikimit njerëzorë. Mund të telefononi ose të dërgoni një postë elektronike në sistemin e ndihmës dhe të tregoni për situatën tuaj.

Nuk duhet të jeni i sigurtë, nëse jeni viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.

Do të merrni një vendim nga sistemi i ndihmës

Gjithmonë do të merrni një vendim me shkrim nëse sistemi i ndihmës mund të ju pranojë si klient.

Mund të na kontaktoni në mënyrë anonime

Nëse dëshironi, mund të na kontaktoni pa dhënë emrin apo adresën tuaj. Mund të flisni me sistemin e ndihmës për situatën tuaj dhe të mendoni nëse dëshironi të bëheni klient i sistemit të ndihmës.

Përmes www.ihmiskauppa.fi faqes mund t'i shkruani sistemit të ndihmës në mënyrë anonime.

Kështu pra kontakti i juaj me ne është i besueshëm apo i mbrojtur.



Sistemi i ndihmës është i detyruar të jetë konfidencial, pra i besueshëm

Sistemi i ndihmës trajton të gjitha informacionet tuaja në mënyrë konfidenciale.

Mund të lexoni më shumë rreth përpunimit të të dhënave tuaja në faqen e internetit:

www.ihmiskauppa.fi/myinfo

- Sistemi i ndihmës regjistron të dhënat personale të personit të paraqitur dhe të pranuar si klient në regjistrin e klientëve të sistemit të ndihmës.
- Përpunimi i të dhënave bazohet gjithnjë në kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj.
- Të dhënat personale të ruajtura duhet të mbahen konfidenciale. Punonjësit që përpunojnë ose shikojnë të dhëna janë gjithmonë të obliguar me konfidencialitetin. Të dhënat mund të përpunohen vetëm nga ata persona që kanë të drejtën ligjore për ta bërë këtë.
- Dokumentet e regjistruara mbahen konfidenciale dhe nuk duhet t'i jepen asnjë pale tjetër për t'i parë ose përdorur.
- Sistemi i ndihmës mund të ofrojë informacione për një dokument konfidencial vetëm me pëlqimin tuaj ose siç përcaktohet në mënyrë specifike me ligj.
- Të dhënat tuaja nuk do t'u jepen shteteve të tjera pa pëlqimin tuaj.



Informata kontaktuese me sistemin për të ndihmuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Tel: +358 295 463 177

Punonjësit e linjës së ndihmës përgjigjen në numrin nga e hënë - të premten ora 8:00 - 16:15

Në ditët tjera, në telefonata përgjigjet qendra e pritjes së Joutseno. Në këto ditë mund të lini kërkesën për telefonatë ose të tregoni për nevojën tuaj urgjente për ndihmë

e-mail: ihmiskauppa.auttamisjarjestelma@migri.fi

www.ihmiskauppa.fi

Në faqen e internetit Ihmiskauppa.fi mund të gjeni informacione rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sistemit të ndihmës dhe organizatave që ofrojnë ndihmë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Nëpërmjet faqes së internetit, ju mund të kontaktoni sistemin e ndihmës në mënyrë anonime